



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË**

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421 205; Fax 033 421-201; www.vlora.gov.al: info@vlora.gov.al

Nr. 5251 prot

Vlorë, 12.11. 2015

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ date _____ / _____ 2015

**PËR
KRIJIMIN E KËSHILLIT TË PËRHERSHËM ARTISTIKO- KULTUROR
TË BASHKISË VLORË**

Bazuar në ligjin 8652 dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", nen 8/II pika b dhe c, nen 10/I pika dh, nen 32 pika e, ligjin nr 10325 dt.18.11.2010 "Për artin dhe kulturën" nen 5, VKM Nr.540, datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", i ndryshuar me VKM Nr. 121, datë 25.2.2005 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre", pika 1, 2 dhe 4, pasi mori në shqyrtim relacionin e Kryetarit të Bashkisë për krijimin e Këshillit të Përhershëm Artistiko Kulturor të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e Këshillit të Përhershëm Artistiko-Kulturor (KPAK) pranë Bashkisë Vlorë.
2. KPAK të përbëhet nga 5 anëtarë, personalitete të shquara të Vlorës në fushën e artit, të kulturës, sportit dhe të shkencës, të cilët do të përcaktohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
3. Mandati i KPAK shtrihet brenda afatit kohor të funksionimit të Këshillit të Bashkisë.
4. Anëtarët e KPAK do të paguhen me një shperblim prej 4.500 lekësh për çdo mbledhje që do të zhvillohet, shpenzim ky që do të përballohet nga fondi i buxhetit të Bashkisë Vlorë për projekte kulturore.
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit nr 8652 .dt.31/07/2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" nen 33 pika 6.

N/Kryetari për Komunikimin dhe Shërbimet Mbështetëse
Arben BEQIRAJ

Drejtori i Drejtorisë Juridike
Daut ZERAJ

K R Y E T A R

Dritan LELL





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË**

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421 205; Fax 033 421-201; E-mail: info@vlora.gov.al

**RELACION
mbi PROJEKT-VENDIMIN
“PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË PËRHERSHËM ARTISTIKO- KULTUROR TË
BASHKISË VLORË”**

Të nderuar Këshilltarë!

Administrata e Bashkisë Vlorë paraqet për diskutim projekt-vendimin “Për krijimin e Këshillit të Përhershëm Artistiko- Kulturor (KPAK) të Bashkise Vlorë”, në zbatim të dispozitave ligjore, siç janë ligji Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, VKM Nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, i ndryshuar me VKM Nr. 121, datë 25.2.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave ”Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”.

Në bazë të këtij kuadri ligjor, pranë Bashkive duhet të ngrihet një organ këshillimor me numër të pacaktuar anëtarësh, të cilët duhet të miratohen nga Këshilli i Bashkisë.

KPAK duhet të ketë në përbërje të tij personalitete të shquara në fushën e artit, të kulturës dhe të shkencës, të cilët nuk duhet të janë të punësuar në institucionet që kane lidhje varësie me Bashkinë Vlorë. Sipas VKM Nr.121, datë 25.2.2005 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave ”Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, KPAK propozojnë dhe japid mendime për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore e artistike të institucioneve, pranë të cilave funksionojnë, për mbështetjen e talenteve të reja dhe vlerësimin e cilësisë artistike etj.

Për probleme të veçanta, me karakter profesional, si dhe për kalendarin vjetor të veprimtarive, që do të zhvillohen nga institucionet, këshillat artistiko-kulturore kanë të drejtë vendimmarrëse.

Për kalendarin vjetor të veprimtarive njoftohet Kryetari i Bashkisë, sipas propozimeve të këshillave artistiko-kulturore.”

Anëtarët e këtyre këshillave prane bashkise do te shpërblehen sipas vendimit të këshillit të bashkisë, por jo më tepër se 4.500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.

KPAK do të ushtrojë funksionet e tij në të gjitha fushat e veprimtarive sportive, kulturore, artistike etj, të cilat do të zhvillohen në qytet, nën kujdesin e Bashkisë Vlorë. Ky KPAK do të ruajë marrëdhene varësie nga administrata e Bashkisë, e cila do të orientojë veprimtaritë e këtij këshilli në perputhje me politikat e miratuara në këto fusha dhe me fondet në dispozicion për veprimtarite kulturore. Kalendar i këtyre veprimtarive, llojet e veprimtarive që do të zhvillohen, do të propozohen nga Administrata e Bashkisë, në perputhje me fondet e institucionit në dispozicion për këtë qëllim. Këto materiale do të diskutohen pranë KPAK, i cili në fund ka të drejtë vendimmarrëse.

Sa më sipër ju ftoj të miratoni këtë project-vendim, për t'i hapur kështu rrugë zhvillimit të aktiviteteve artistiko-kulturore e sportive në qytetin e Vlorës, të cilat do të kërkojnë mbështetjen me fonde financiare nga Bashkia.

Duke Ju falenderuar!

KRYETAR

Dritan LELI